



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

# ZGJEDHJET PARLAMENTARE KOSOVË 2014

**Qershor 2014**

**[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)**

Manuali jep një vështrim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014 me të gjitha informatat e rëndësishme në lidhje me procesin elektoral, modelin e votimit, monitorimin e zgjedhjeve, organet zgjedhore, sistemin kosovar për zgjedhjet parlamentare, partitë politike, historik të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë si dhe një pjesë analitike mbi mandatin e legjislaturës 2010-2014.



## **Manual për Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2014 në Republikën e Kosovës**

**Granit Tërnavaj  
Milot Rexhepi**

## HYRJE

### Zgjedhjet parlamentare në Kosovë, përshkrim i shkurtër i mandatit të legjislaturës 2010 - 2014

Zgjedhjet e pesta parlamentare në Kosovën e pasluftës do të mbahen me 8 qershor 2014<sup>1</sup>. Këto zgjedhje do të jenë të jashtëzakonshme si rezultat i shpërndarjes së parlamentit të Kosovës me 90 vota pro në seancën e 7 majit<sup>2</sup>. Kërkesa për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës u paraqit me nënshkrimet e 55 deputetëve, kryesisht nga dy partitë më të mëdha në vend ( PDK dhe LDK) si rezultat i marëveshjes së liderëve politik dhe pas një mori konsultash të kryera mes klasës politike në vend e që kishin qëllim kryesor ruajtjen e funksionimit të institucioneve të vendit<sup>3</sup>.

Vendi po përballëj me kriza të njëpasnjëshme institucionale në mungesë të një shumice të konsoliduar parlamentare për një periudhë më të gjatë por që u bë më e dukshme me përfundimin e zgjedhjeve lokale të fundvitit 2013. Një pjesë e madhe e mandatit të kësaj qeverisje ishte përshkruar me probleme me partnerët e koalicionit por edhe brenda partisë më të madhe në qeveri PDK-së.

Pas një procesi zgjedhor të jashtëzakonshëm pas shpërbërjes së Kuvendit, zgjedhjet e vitit 2010 u përshkuan me shumë vjedhje dhe keqpërdorime të votës. Edhe pse dyshimet për keqpërdorime u dëshmuuan në shumë anë të Kosovës, Gjykata Supreme vendosi që zgjedhjet të përsëriten tërësisht në tri komuna të Kosovës dhe pjesërisht edhe në tri komuna tjera<sup>4</sup>. Keqpërdorimet dhe vjedhjet e votave ishin ndër temat kryesore të mandatit pothuajse katër vjeçar të kësaj qeverisje dhe parlamenti duke dëmtuar rëndë demokracinë dhe ulur në shumë debatin parlamentar gjatë këtyre viteve .

Koalicioni qeveritar i arritur mes PDK-së, Koalicionit për Kosovë të Re dhe shumicës së partive minoritare kishte

në fillimet e saj 65 deputet në radhët e saj<sup>5</sup>. Në marëveshjen e arritur ishte premtuar që posti i presidentit të vendit ti ipej presidentit të AKR-së Behgjet Pacollit. Presidenti i vendit sipas Kushtetutës së vendit përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës dhe në dy rundet e para për zgjedhjen e tij kërkohen 2/3 e votave të deputetëve të Republikës së Kosovës<sup>6</sup>. Vetëm në rast që asnjëri prej kandidatëve nuk merr 2/3 e votave organizohet rundi i tretë i votimit dhe kandidati që merr shumicën e thjeshtë të votave zgjidhet për pozitën e presidentit me një mandat 5 vjeçar<sup>7</sup>.

Por, procesi i zgjedhjes së presidentit duket të ketë qenë fillimi i një mandati me shumë probleme për koalicionin e sapo formuar më 2011. Sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Jakup Krasniqi, një figurë e fuqishme partiake i kishte shprehur me kohë ambicjet e tij për zgjedhjen në pozitën e kryetarit, pozitë kjo të cilën e ushtronte pas dorëheqjes së presidentit para-prak, Fatmir Sejdiut i cili u gjend nga Gjykata Kushtetuese si shkelës i Kushtetutës me rastin e mbajtjes së ngrirë të pozitës së tij si kryetar i LDK-së<sup>8</sup>. Procesi i negociatave mes partnerëve të koalicionit ishte i rëndë dhe dukej që PDK-ja nuk kishte zgjidhje tjetër për koalicion pas refuzimit të LDK-së dhe AAK-së për të qenë në qeverisje<sup>9</sup>.

Situatën më të rënduar e bëri edhe fakti që pas një presioni të madh pas dyshimeve të tij për përfshirje në korrupsion, nënkryetari i parë i PDK-së dhe njeriu i dytë i votuar brenda brenda listës së saj, Fatmir Limaj vendosi të tërhiqej nga pozitat qeveritare dhe të mбетet vetëm deputet i kuvendit të Kosovës.

Megjithë këto probleme dhe duke pasur kundërshtimin e disa deputetëve nga PDK-ja për propozimin e Behgjet Pacollit për president, partnerët e vendosin atë në votim dhe pas dy rundeve të dështuara dhe pas një presioni të madh ushtruar deputeteve për të votuar, Behg-

---

<sup>1</sup> Zgjedhjet Mbahen më 8 Qershor. Artikulli mund të gjendet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,8174> , shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>2</sup> <http://www.telegrafi.com/lajme/me-90-vota-per-shperndahet-kuvendi-i-kosoves-2-44465.html> , shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> <http://www.gazetatema.net/web/2011/01/07/edhe-mitrovicane-rivotim/> , shikuar së fundmi më 29.05.2014.

---

<sup>5</sup> <http://www.abcnews.al/lajme/rajoni/7/2791> , shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>6</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli 5, Statusi i Presidentit, Zgjedhja e Presidentit, Neni 83-86, , faqe 31-33.

<sup>7</sup> Po aty, neni 87, faqe 33.

<sup>8</sup> <http://www.dw.de/presidenti-sejdiu-jep-dor%C3%ABheqjen/a-6049627> , shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>99</sup> [http://www.balkanweb.com/bw\\_lajme2.php?IDKategoria=26&IDNotizia=50742&res\\_start=40](http://www.balkanweb.com/bw_lajme2.php?IDKategoria=26&IDNotizia=50742&res_start=40) , shikuar së fundmi më 29.05.2014.

jet Pacolli zgjedhet president i Republikës së Kosovës<sup>10</sup>.

Por mbajtja e pozitës së tij u kontestua shumë shpejtë nga partitë opozitare të cilat e akuzonin Pacollin për shkelje të Kushtetutës qysh në ditën e zgjedhjes së tij. Pas kërkesës së depuzituar nga LDK dhe AAK për komentim vlerësim të procedurës së zgjedhjes së tij si dhe votimit që ai kishte bërë për qeverinë<sup>11</sup>, gjykata Kushtetuese shpalli vendimin me të cilin i jepte të drejtë opozitës dhe e vlerësonte Behgjet Pacollin si shkelës të Kushtetutës<sup>12</sup>.

Pas këtij vendimi të Kushtetutës, vendi zyrtarisht po futej në një krize institucionale dhe që mund të kishte pasoja të mëdha për vendin. Në këto rrethana, Hashim Thaqi nga PDK, Isa Mustafa nga LDK dhe Behgjet Pacolli nga AKR zhvilluan një mori bisedash me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar ( me së shumti atij amerikan) për kalimin e ngërqit institucional që kishte në ato momente vendi. Duke e vlerësuar që situata kishte ardhur si rezultat i manipulimit zgjedhor dhe zgjedhjes së presidentit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, liderët e vendit arritën një marrëveshje politike për fillimin e reformës kushtetuese dhe zgjedhore që do të bazohej në dy elemente kryesore: zgjedhjen e presidentit direkt nga populli si dhe përpilimin e një kodi të ri zgjedhor që do të pamundësonte vjedhjen e votës dhe do të parashihte ndëshkime më të rënda për keqpërdoruesit e saj<sup>13</sup>. Si kandidate për presidente u propozua Atifete Jahjaga, një zyrtare e lartë në hierarkinë e Policisë së Kosovës<sup>14</sup> e cila edhe u votua në Parlamentin e Kosovës më shumicë të dyfishtë.

Pas problemeve fillestare që kishte me koalicionin dhe mbajtjen e numrave, ky mandat qeverisës dhe parlamentar njihet poashtu edhe me sfidat e shumta që kishte në lidhje me dialogun me Serbinë, dialog ky i kërkuar shumë nga faktori ndërkombëtar por dhe që poashtu shihej i nevojshëm për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Procesi i dialogut kishte ndodhur edhe në faza të mëparshme por tashmë ishte koha për dialog të nivelit më të lartë politik dhe për të cilin duheshin bërë marrëveshje më të mëdha dhe me më peshë politike. Duke pasur parasysh koston eventuale politike dhe peshën e vendimeve që do të duheshin të merreshin, kryeministri Thaqi kërkoi konsensus politik përballë këtij procesi të vështirë. Si rrallëherë në vendime, shumica e partive politike ( përveq Vetëvendosjes që është në parim kundër bisedimeve me Serbinë pa u plotësuar disa kushte themelore si ai i vetëvendosjes së popullit dhe kërkim-faljes nga Serbia<sup>15</sup>) ishin pro dialogut me Serbinë duke mos i krijuar ndonjë kosto të dëmshme politike kryeministrit të vendit. Gjatë kësaj periudhe, një mori marrëveshjes u arritën por si më kryesorja llogaritet ajo e datës 19 prill 2013 ku palët u pajtuan në një marrëveshje 15 pikëshe që ka për qëllim normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Ndër pikat kryesore të kësaj marrëveshje janë ato që lidhen me formimin e Bashkësisë/Asociacionit të Komunave të Kosovës si dhe asaj të shuarjes së strukturave paralele të sigurisë dhe përfshirjen e pjesëtarëve të tyre në strukturat e Policisë së Kosovës<sup>16</sup>. Edhe pse me një debat të rëndë dhe me një tensionim të lartë, kuvendi ratifikoi këtë marrëveshje me 84 vota pro ( me votat e shumicës së partive, dhe me votë bllok kundër të Vetëvendosjes)<sup>17</sup>.

Kjo legjislaturë u përball poashtu edhe me vendime tjera të rëndësishme të cilat edhe nuk mundi ti kalojë e që sollën përfundimin definitiv të mandatit dhe shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Pas raportimeve të mëhershme për dyshime për trafikim organesh dhe autorizimit të një hetimi më të thellë, komuniteti ndërkombëtar ka bërë një kërkesë të prerë për liderët e vendit që të themelojnë një gjykatë speciale që do të merrej me krimet e luftës e që do të kishte seli edhe në një vend tjetër European ( sipas të gjitha gjasave në Holandë), Kuvendi i Kosovës u përball me sfidën më të rëndë të kësaj legjislature. Duke pasur si opcion tjetër

<sup>10</sup> <http://botasot.info/kosova/105503/behgjet-pacolli-president-i-kosoves/7>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>11</sup> <http://www.evropaelire.org/content/article/2324780.html>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>12</sup> <http://lajmetshqip.com/kosove-gjykata-kushtetuese-rrezon-presidentin-pacolli/>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>13</sup> <http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/atifete-jahjaga-kandidate-per-presidente-te-kosoves>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> JO NEGOCIATA – VETËVENDOSJE!. Artikulli mund të gjendet në: <http://www.vetevendosje.org/jo-negociata-vetevendosje/>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>16</sup> Nënshkruhet marrëveshja Kosovë – Serbi. Artikulli mund të gjendet në: <http://kohane.net/arkiva/?page=1,13,143112>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>17</sup> Megjithë tensionimin Kuvendi ratifikoi marrëveshjen Kosovë-Serbi. Artikulli mund të gjendet në: <http://www.telegafi.com/lajme/megjithë-tensionimin-kuvendi-ratifikoi-marreveshjen-kosove-serbi-video-2-33514.html>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

themelimin e kësaj gjykate nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe duke e vlerësuar atë si një "kompromis të dhimbshëm", deputetët e kuvendit të Republikës së Kosovës miratuan me 89 vota për themelimin e një gjykate speciale që do të hetonte krimet e luftës në Kosovë.<sup>18</sup>

Duke dalur edhe më i brishtë si kuvend pas një vendimi kaq të rëndë dhe duke pasur parasysh mungesën e një pozite të konsoliduar por edhe të një opozite të bashkuar, liderët politikë filluan negociatat për shpërbërjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pas dështimit të votimit të reformës edhe ashtu të përgjysëmuar zgjedhore dhe mungesës së votave të minoritarëve për themelimin e ushtrisë së Kosovës të cilët e kushtëzonin atë me vazhdimin e vendeve të rezervuara për ta, Kuvendi i Kosovës u shpërbë duke hapur rrugën për zgjedhjet e jashtëzakonshme.

## Historik i zgjedhjeve parlamentare në Kosovë 2001- 2010

### - Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2001

Pas një periudhe mëse dy vjeqare të administrimit direkt ndërkombëtar, vendi duket të ishte i gatshëm të themelonte institucionet e saja vetëqeverisëse të cilat do të dilnin nga votat e qytetarëve. Për herë të parë në Kosovën e pasluftës, qytetarët e saj votuan në zgjedhjet parlamentare më 17 nëntor 2001<sup>19</sup>, një vit pasi ata kishin votuar për zgjedhjet lokale. Numri i votuesve në këto zgjedhje, ishte 1.249.987, kurse pjesmarrja në votime ishte 64%. Këto zgjedhje u bënë me lista të mbyllura, dhe u votua vetëm për subjektin politik. Subjektet politike, i caktuan kandidatët e tyre në listë. Kishte një zonë elektorale (Kosova).

U zgjodhën 100 deputet, kurse 20 vende ishin të rezervuara. 1/3 e kandidatëve deputet, është përcaktuar në bazë të gjinisë. U votua në 1.668 vendvotime dhe pati, 498 qendra votuese<sup>20</sup>.

<sup>18</sup> Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e Gjykatës speciale. Artikulli mund të gjendet në:

<http://www.telegafi.com/lajme/kuvendi-i-kosoves-miratoi-themelimin-e-gjykates-speciale-2-43822.html>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>19</sup> Zgjedhjet e përgjithshme: <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>20</sup> Zgjedhjet e përgjithshme: <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

Rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve të para parlamentare në Kosovë ishin në favor të plotë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) e cila fiton

46.2 % të votave duke marrë 47 vend në Parlament<sup>21</sup>. Partia e dytë ishte Partia Demokratike e Kosovës me 25.5 % dhe kishte 26 vende në Parlament e përcjellur nga Alenaca Kthimi, aleancë kjo e themeluar nga pjesëtarë të komunitetit serb me 10.9 përqind dhe që kishte 22 vende (në këtë numër janë përfshirë edhe vendet e rezervuara për komunitetin serb), e katërta ishte Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.8 % të votave dhe me 8 vende në parlament ndërsa vendet e mbetura janë shpërndarë mes partive të tjera dhe të komuniteteve që jetojnë në Kosovë<sup>22</sup>.

Seanca e parë inaguruese e Kuvendit u mbajt më 10 dhjetor 2001. Duke vlerësuar tensionimin e lartë që egzistonte mes subjekteve politike por dhe duke vlerësuar si të rëndësishëm stabilitetin e vendit, me ndikim poashtu të faktorit ndërkombëtar u vendos që të krijohet një koalicion i gjerë mes tri partive më të mëdha shqiptare në kuvend si dhe pakicave. Ky koalicion siguronte një shumicë të kualifikuar në Kuvend me gjithsesi 83 deputet ose 69.2 të përbërjes totale të Kuvendit<sup>23</sup>. Nga kjo marrëveshje, Ibrahim Rugova nga LDK u zgjodh president i Kosovës<sup>24</sup> ndërsa Bajram Rexhepi nga PDK-ja u zgjodh kryeministër i parë i Kosovës<sup>25</sup> dhe sektorët qeveritar u ndanë varësisht fuqisë së subjektit politik.

### - Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2004

Zgjedhjet parlamentare të tetorit të vitit 2004 erdhën në një kohë të veshtirë, kur Kosova po perballlej me

<sup>21</sup> Përmbledhje e zgjedhjeve. Artikulli mund të gjendet në:

[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/infoElection/s/setimes/resource\\_centre/elections/kosovo\\_assembly\\_2001?country=Kosovo](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/infoElection/s/setimes/resource_centre/elections/kosovo_assembly_2001?country=Kosovo), shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>22</sup> Po aty

<sup>23</sup> Forum 2015: Mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë. 2013. Punuar nga Instituti Demokratik i Kosovës. Artikulli mund të gjendet në: <http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/09/Mbi-10-vjet-Parlamentarizem-ne-Kosove-ALB.pdf>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>24</sup> Presidentët e Kosovës. Dr. Ibrahim Rugova, Presidenti historik i Kosovës. <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,109>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>25</sup> Bajram Rexhepi. Kryeministër i Kosovës. Artikulli mund të gjendet në: [http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/infoBios/setimes/resource\\_centre/bio-archive/rexhepi\\_bajram](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/infoBios/setimes/resource_centre/bio-archive/rexhepi_bajram), shikuar së fundmi më 29.05.2014.

akuza të rënda në lidhje me trazirat e marsit te po atij viti. Shih për kete dhe arsyje tjera, Serbia kategorikisht i kundërshtoi keto zgjedhje dhe nuk pranoi fare te bashkëpunonte në mënyrë që serbëtë ushtronin të drejtën e tyre për tu zgjedhur.<sup>26</sup>

Edhe këto zgjedhje si ato të vitit 2001, u administruan nga OSCE, listat ishin te mbyllura dhe ishte vetëm një zonë zgjedhore. Në këto zgjedhje, LDK doli fituese me 45.42% te votave, PDK kishte 28.85%, AAK 8,39, ORA 6.2 dhe partitë e tjera të vogla dhe minoritetet morën vendet tjera.

Koalicioni qe u be ishte historik per vendin per disa arsye. E para ishte se LDK si nje parti e ashtuquajur pacifiste bëri koalicion me një parti që përfaqësonte krahun e luftës. Ndërsa arsyeja e dytë ishte se AAK me vetëm 8,39% te votave merr postin e kryeministrit, te udhëhequr nga Ramush Haradinaj. Në anën tjetër LDK mori postin e Presidentit të udhëhequr nga Ibrahim Rugova dhe postin e kryetarit të Parlamentit te udhëhequr nga Nexhat Daci.

### - Zgjedhjet parlamentare te vitit 2007

Pas një procesi të tejzgjatur bisedimesh me Serbinë për zgjedhjen e statusit përfundimtar të Kosovës me ndërmjetësimin e ekipit ndërkombëtar me në krye presidentin Ahtisari, u vendos qe të shkohej në zgjedhje të përgjithshme edhe pse kjo nuk përkonte shumë me afatet ligjore. Shkuarja në këto zgjedhje bëhej për dy arsye kryesore: qeverisja e atëhershme ishte e brishtë dhe vendit i parlamentit të ri i duhej një legjitimitet më i madh për të marr veprimet e ardhshme që do të ndërlihdeshin me shpalljen e pavarësisë, miratimin e Kushtetutës dhe një mori ligjesh tjera që lidheshin me obligimet ndërkombëtare që do të merrte Kosova nga plani i Ahtisarit për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës.

Pas vdekjes së Ibrahim Rugovës, LDK-ja hyri në një proces të vështirë të zgjedhjeve të brendshme të cilat nuk kaluan pa pasoja për partinë e cila ishte kryesorja në dy legjislaturat e kaluara të Kosovës së pasluftës. Një proces i tensionuar dhe me shumë akuza të ndërsjella mes dy kandidatëve për të parin e partisë, Fatmir Sejdiut dhe Nexhat Dacit u finalizua me një ndarje të dhimbshme dhe të pakthyeshme. Nexhat Da-

ci, së bashku me një grup të konsiderueshëm të anëtarëve të partisë, të pakënaqur me përfshirjen e tyre në këshillin e përgjithshëm të partisë pas humbjes së këtij të fundit në garën për kryetar, vendosën të themelojnë një parti të re dhe të ndaheshin përfundimisht nga partia amë.

Kjo rrethanë më së shumti favorizonte Hashim Thaqin dhe PDK-në, të cilët të lodhur nga qëndrimi në opozitë dhe si parti e dytë që nga themelimi, kishin përforcuar poashtu rradhët me pjesëtarë me nam nga shoqëria civile dhe bota akademike që shërbyen mjaft mirë për ndryshimin e imazhit të kësaj partie, që deri atë kohë lënte shumë për të dëshiruar.

Me një program të qartë dhe një fushatë të organizuar mirë, përballë një LDK-je të dëmtuar rëndë nga ndarja dhe e dalur nga një mandat me shumë problem nga qeverisja, PDK-ja doli për herë të parë në Kosovën e pasluftës si partia triumfuese e zgjedhjeve.

Duke vlerësuar nevojën për një qeverisje të qëndrueshme dhe që do u bënte ballë më lehtë sfidave që e prisnin vendin në prag të shpalljes së pavarësisë dhe ne menaxhimin fillestar të post-pavarësisë, liderët e PDK-së dhe LDK-së vendosën që të bëjnë koalicion mes tyre dhe minoriteteve<sup>27</sup>. Nga ky koalicion, kryeministër i vendit u zgjodh Hashim Thaqi nga PDK, president i vendit Fatmir Sejdiu nga LDK dhe kryeparlamentar Jakup Krasniqi nga PDK. Ndarja e ministrive u bë duke u bazuar në fuqinë parlamentare të partnerëve të koalicionit.

### - Zgjedhjet Parlamentare te vitit 2010

Koalicioni i panatyrshëm PDK-LDK nuk kishte jetëgjatësinë e paraparë dhe u ndërpre para kohës së përcaktuar. Në shtator të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës vendosi se presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, kishte shkelur Kushtetutën e Kosovës duke mbajtur njëkohësisht postin e presidentit të vendit dhe atë të liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës<sup>28</sup>. I gjendur përballë kësaj situate, Fatmir Sejdiu

<sup>27</sup>Forum 2015: Mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë. 2013. Punuar nga Instituti Demokratik i Kosovës. Artikulli mund të gjendet në: <http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/09/Mbi-10-vjet-Parlamentarizem-ne-Kosove-ALB.pdf>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>28</sup> Sejdiu e ka shkelur seriozisht Kushtetutën. Artikulli mund të gjendet në: <http://www.telegafi.com/lajme/sejdiu-e-ka-shkelur-seriozisht-kushtetuten-2-10483.html>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>26</sup> ICG, Kosovo: Toward Final Status, 24.01. 2005, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/161-kosovo-toward-final-status.aspx>

dha dorëheqje nga pozita e presidentit duke e nisur një krizë insitucionale. Disa ditë më vonë, ministrat e LDK-së u tërhoqën nga pozitat që ata ushtronin duke dhënë dorëheqje dhe zyrtarisht duke e futur vendin në një krizë institucionale të cilën Hashim Thaqi nuk do të mund ta menaxhonte i vetëm <sup>29</sup>.

Në një situatë të tillë, me kërkesë të inicuar nga AKR-ja e Behgjet Pacollit dhe me votim edhe të PDK-së, qeveria u rrëzua duke i hapur rrugë zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Të planifikuara të mbahen në një kohë të ftoftë dhe pa organizim të gjerë dhe në afat të jashtëzakonshëm të mbajtjes, zgjedhjet e para të organizuara në Kosovën e pavarur dhe me organizim 100 % nga organet lokale zgjedhore ishin larg standardeve të kërkuara ndërkombëtare por ishin poashtu larg standardeve të zgjedhjeve paraprake. Procesi i zgjedhjeve u përsërit tërësisht në tri komuna të vendit si dhe pjesërisht në tri komuna tjera. Dyshimet për keqpërdorime mes partive por edhe brenda vetë listave të partive politike ishin të mëdha duke e bërë këtë si temë kryesore edhe e mediave të ndryshme ndërkombëtare <sup>30</sup>.

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 12 Dhjetorit 2010 janë mbajtur në 745 Qendra të Votimit me gjithsejt 2280 Vendvotime ndërsa numri i votuesve të regjistruar ka qenë 1,630,636. Në zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës kanë garuar gjithsejt 29 Subjekte Politike <sup>31</sup>.

Pas përfundimit të procesit të rivotimit në komunat dhe pikat e kontestuara, përfundimisht PDK-ja ishte përsëri partia e parë me 32.11%, LDK e dyta me 24.69 %, Vetëvendosje e treta me 12.69 %, AAK me 11.04 %, dhe Koalicioni AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSH-PGJK me 7.29 % <sup>32</sup>.

Mandatari i qeverisë, Hashim Thaqi arriti koalicion me Koalicionin AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSH-PGJK dhe një pjesë të komuniteteve duke siguruar një shumicë prej 65 deputetëve.

## - Sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës

Përkundër marëveshjes së Prillit të vitit 2011 ndërmjet tre liderëve Hashim Thaçit, Isa Mustafës dhe Behgjet Pacollit për të reformuar sistemin zgjedhor, kjo nuk u arrit dhe zgjedhjet e 8 qeshorit 2014 do të mbahen me ligjin e vjetër. Procesi zgjedhor do të përgatitet dhe menaxhohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) në pjesën më të madhe të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar veriun e Kosovës ku si përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve është OSCE-ja.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashesh shumë qartë të drejtën e votës të secilit individ. Çdo person që ka arritur moshën 18 vjecare ka të drejtën e votës por edhe të garës për zgjedhje. Kjo e drejtë i mohohet vetëm në qoftëse personi e ka të ndaluar me vendim gjyqësor. <sup>33</sup>

Republika e Kosovës është një republikë parlamentare me sistem të përfaqësimit proporcional me formulën Sainte-Laigue<sup>34</sup> dhe me vetëm nje zonë zgjedhore. Zgjedhjet e rregullta për kuvend janë paraparë të mbahen çdo katër (4) vjet, përveç nëse ka zgjedhje të parakohshme apo nese shpallet gjendje e jashtëzakonshme<sup>35</sup>. Në të dyja rastet, presidenti i

<sup>29</sup> Kosova në krizë pasi LDK largohet nga qeveria. Artikulli mund të gjendet në: <http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2010/10/18/feature-01>, shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>30</sup> Kosovo's election. Calm now, a storm to come?. Artikulli mund të gjendet në: [http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2010/12/kosovos\\_election](http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2010/12/kosovos_election), shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>31</sup> Zgjedhjet e përgjithshme. <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme> shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>32</sup> ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2010. Rezultatet e përgjithshme. Statistikat mund të gjenden

në [http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/rezultatet\\_e\\_pergjithshme\\_eyeodh\\_pohj.pdf](http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/rezultatet_e_pergjithshme_eyeodh_pohj.pdf), shikuar së fundmi më 29.05.2014.

<sup>33</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 45, Pika1, faqe 14

<sup>34</sup> Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të fituara nga secili subjekt politik në zgjedhjet për Kuvend pjesëtohet me 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, e kështu me radhë derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të plotë të vendeve. Gjendet në

[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/2008\\_03-L073\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/2008_03-L073_al.pdf)

<sup>35</sup> Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për aq sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme. Gjendet: Po aty

Republikës shpall datën e zgjedhjeve dhe që me ligj duhet te jetë ditë e diel.<sup>36</sup>

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka gjithsej 120 vende ku 20 prej tyre janë të garantuara për komunitetet dhe 30% prej tyre duhen të jenë të gjinisë femërore. Në fakt, i vetmi ndryshim në këto zgjedhje ka të bëjë me vendet e rezervuara të komuniteteve që tani bazuar në pakon e Ahtisarit që pas dy mandateve janë konvertuar në vende të garantuara. Pra komuniteti Serb i ka dhjetë (10) vende të garantuara, dhe nese votat e fituara janë më pak se 10 vende, ata përsëri do ti kenë 10 deputet ne Kuvend. E njëjta ndarje vlen edhe për komunitetet tjera.<sup>37</sup>

Ndarja totale është kjo, Serbët kanë dhjetë (10) vende te garantuara, duke pasuar me Boshnjakët me tre (3), Turqit dy (2), Goran një (1), Rom një (1), Ashkali një (1), Egjiptian një (1) dhe një (1) vend tjetër do ti shkoj njërit nga komunitetet RAE varësisht se cili ka më shumë vota.<sup>38</sup>

Praktikisht në lojë mbesin 100 vende ku entitetet e tjera shqiptare synojnë të marrin shumicën e ulseve në mënyrë që të jenë bartëse të formimit te qeverisë. Megjithatë entitetet politike duke përjashtuar ato të komuniteteve e kanë si kusht kalimin e pragut zgjedhor prej 5%.

Qytetarët e Republikës së Kosovës përmes listave të hapura kanë të drejtë që ta zgjedhin një subjekt politik dhe pesë(5) kandidatë të listës zgjedhore.

### - Organet Zgjedhore

Organi i cili përgadit dhe menaxhon procesin zgjedhor është Komision Zgjedhor i Zgjedhjeve nje organ i pavarur. Megjithatë nëse shikojmë historikun e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, që nga viti 2000 dhe deri në vitin 2007 këtë proces e ka udhëhequr OSCE. Kjo e fundit do ta ketë rolin kryesor në menaxhimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve në veri të vendit.

KQZ është institucion i pavarur që përbëhet nga 11 anëtarë, kryetarin që duhet të vij nga Gjykata Supreme dhe që emërohet nga Presidenti i Kosovës. Ndërkaq gjashtë (6) të tjerët nominohen nga grupet parlamentare më të mëdha dhe katër (4) përfaqësues të komuniteteve.<sup>39</sup>

KQZ përveq tjerash është e obliguar të bëj fushatë për senzibilizimin e votuesve për të drejtat e tyre dhe sanksionet që mund ti kenë në rast të shkeljes së ligjit. KQZ gjithashtu çertifikon partitë politike dhe kandidatët për deputet, shpall rezultatet, certifikon vëzhguesit dhe mbikqyr shpenzimet e entiteteve politike. KQZ është e shtrirë në tërë komunat e Republikës së Kosovës nëpërmjet KKZ-ve. Ky organ administron zgjedhjet në atë territor të komunës në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe rregullat e KQZ-së.<sup>40</sup> Pjesë e KQZ-së është edhe sekretariati i cili mirret më shumë me anën teknike.

Një tjetër organ i pavarur dhe shumë i rëndësishëm është Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtesa (PZAP). Ky organ pranon ankesa të cilat mund të jenë në kundërshtim me ligjin, dhe vendimet e këtij të fundit janë obligues për të gjitha palët. PZAP ka të drejtë të sanksionojë partitë politike, të ndalojë një parti politike apo individ të marrë pjesë në procesin zgjedhor dhe shumë sanksione tjera të paraparë me ligj. Përndryshe PZAP ka pesë (5) anëtarë që emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme.<sup>41</sup>

### - Fushata Zgjedhore

Bazuar në ligjin për zgjedhjet në Republikën e Kosovës, të gjitha partitë politike e kanë të drejtën e të bërit fushatë dhe të propagandojnë në media. Megjithatë kjo nuk do të thote që partitë politike dhe kandidatët nuk kanë limite ligjore për shpenzime gjatë fushatës. Bazuar në përvojat e kaluara zgjedhore, fshehja e shpenzimeve gjatë fushatës mbetet problem kyq i evidentuar edhe nga shoqëria civile. Sipas analistëve, partitë politike kanë mbështetje të donatorëve të fuqishëm, të cilët pas zgjedhjeve përfitojnë nga

<sup>36</sup> Ligji Nr. 03/L-073, Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 4, Pika 4.2, gjendet: Po aty

<sup>37</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 46, pika 1, gjendet në: <http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

<sup>38</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 46, pika 2, gjendet në <http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

<sup>39</sup> <http://www.kqz-ks.org/sq/rreth-kqz>

<sup>40</sup> Ligji Nr. 03/L-073, Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 68 gjendet në [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L073\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L073_al.pdf)

<sup>41</sup> Ligji Nr. 03/L-073, Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 115, gjendet në [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L073\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L073_al.pdf)

tenderët respektivisht nga buxheti i Republikës së Kosovës.<sup>42</sup> Partitë Politike kanë të drejtë të shpenzojnë 50 cent per votues dhe çdo shpenzim që kalon shumën e 100 Eurove duhet të paraqitet dëftesa.<sup>43</sup>

Në fakt fushata e partive politike mund të themi se ka filluar shumë më herët. Liderët e partive politike por edhe kandidatët kanë filluar që komunikimin e tyre ta zhvillojnë përmes rrjeteve sociale që është një model i ri krahasuar me zgjedhjet e kaluara. Gjatë fushatës rol të rëndësishëm padyshim luajnë edhe mediat të cilat bazuar në parafushtatën e partive politike, kanë filluar të transmetojnë debate me parti dhe analistë politikë.

Për dallim nga zgjedhjet e kaluara ku edhe me ligj parashihet që fushata të zgjasë 30 ditë, kësaj radhe KQZ ka vendosur që fushata të zgjatë vetëm dhjetë (10) ditë duke qenë se janë zgjedhje të parakohshme.

## - Partitë kryesore të Kosovës gjatë mandatit aktual parlamentar

### - PDK

Demilitarizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UCK) menjëher pas luftës, nuk e dëmtoi strukturën e tyre por vetëm i sistemoj ata në organizata tjera. Kështu disa ju bashkangjiten Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK), disa Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), disa Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK), dhe pjesa tjetër më 10 tetor 1999 formuan Partinë për Progres Demokratik të Kosovës në krye me Hashim Thacin.<sup>44</sup>

Hashim Thaci njihet si lideri politik i UÇK-ës.<sup>45</sup> Megjithatë, edhe pse të gjithë pjestarët e UCK-së gëzonin përkrahje nga popullata, partia e tyre nuk po arrinte ta bindte elektoratin duke mbetur partia e dytë në vend për shumë gjatë. Pas një kohë të shkurtë, PDDK ndryshon emrin në Partia Demokratike e Kosovës

(PDK), duke mos prezentuar ndonjë ideologji të caktuar por më shumë duke u thirrur në vlerat e luftës.

Në vitin 2000 PDK humbi shumicën e komunave të cilat i administronte menjëher pas luftës. Një vit më vonë zhgënjimi u shtua pasi që totali i votave ishte 25.7%, megjithëse ishin pjesmarrës në qeveri duke përfutur postin e kryeministrit që ishte vendosur të jetë Bajram Rexhepi pas shumë dilemave.<sup>46</sup>

PDK vazhdoi të periudhen e ngritjes së ngadalshme në vitet në vazhdim dhe në zgjedhjet e vitit 2004 fitoi 28.85. Momentumi i PDK-së vjen pas vdekjes së liderit Ibrahim Rugova, ku LDK u përça dhe u nda në dy parti.<sup>47</sup> Këtu, PDK filloi një ofansivë të madhe ku angazhoi figura të reja në parti dhe formoi qeverinë nën hije.<sup>48</sup> Dhe në zgjedhjet e vitit 2007 PDK më në fund arrin që të bëhet partia e parë në vend duke fituar 34.3%. PDK vazhdon të jetë në qeveri edhe sot pasi që edhe në zgjedhjet e vitit 2010 arriti të dilte fituese me 32.11% të votave.

Në zgjedhjet lokale te vitit 2013, PDK humbi shumë komuna të rëndësishme sic janë Gjilani, Mitrovica dhe Ferizaj që ishin goditje të mëdha për bazat kryesore të votuesve të kësaj partie. Humbja e PDK-së në këto komuna dhe afrimi shumë i ngushtë me rivalin kryesor LDK-në është edhe si pasojë e ikjes nga dy themeluesit e kësaj partie, dhe ndër personat më të votuar, Fatmir Limaj dhe Jakup Krasniqi Ata themeluan iniciativën të quajtur NISMA e cila shihet si një parti politike që synon të dëmtojë PDK-në. Të dytë, Z. Limaj dhe Z.Krasniqi ishin anëtarë themelues të PDK-së dhe ishin i dyti dhe i treti si njerëzit më të votuar në parti, kështu që largimi i tyre nga PDK e ka vendosur atë në pozitë të vështirë.

<sup>42</sup> Miliona Euro për fushatë, Artikulli mund të gjendet në <http://www.zeri.info/artikulli/31353/miliona-euro-per-fushate>, Shikuar së fundmi më 27.05. 2014.

<sup>43</sup> Ligji Nr. 03/L-073, Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 40

<sup>44</sup> International Crisis Group, "What Happened to the KLA", 3.03.2000, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/088-what-happened-to-the-kla.aspx>

<sup>45</sup> International Crisis Group, Kosovo: Landmark Elections, 21.11.2001 gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/120-kosovo-landmark-election.aspx>

<sup>46</sup> International Crisis Group, Kosovo RoadMap(II): Internal Benchmarks, 01.03.2002, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/op-eds/125-a-kosovo-roadmap-II-internal-benchmarks.aspx>

<sup>47</sup> Hofmeiser, Eilhelm dhe Graboë, Karsten, Partitë politike, Funkzioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike. Kapitulli 8, Partitë Politike në Kosovë, Xhemaj, Bashmir, faqe 105, Prishtinë, Prill 2013. Editor dhe botues: Fondacioni Konrad Adenauer. Ky libër mund të gjendet në : [http://www.kas.de/wf/doc/kas\\_34067-1522-2-30.pdf?130417185744](http://www.kas.de/wf/doc/kas_34067-1522-2-30.pdf?130417185744) .

<sup>48</sup> International Crisis Group, Kosovo After Haradinaj, 26.05.2005, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/163-kosovo-after-haradinaj.aspx>



Zyrtarët e NISMA-s kanë qenë kritikë ndaj dialogut me Serbinë por nuk e kanë refuzuar atë zyrtarisht. NISMA nuk ka orientim të qartë ideologjik, por mesa duket është më shumë parti e qendës së majtë. NISMA nuk ka përjashtuar asnjë prej partive si partnerë koalicioni. Ata do të përpiqen ta kalojnë prapë prej 5 %.

Sidoqoftë kryeministri Thaci ka filluar fushatën shumë herët, duke bërë rritje të pagave<sup>49</sup>, vizitat e shumta në kompani, shkolla, qerdhe dhe duke bërë premtime për punësimin e 200 mijë personave në mandatin e ardhshëm, edhe pse sipas shumicës së analistëve politikë, shumicën e premtimeve që ata dhanë ( lufta kundër korrupsionit, liberalizimi i vizave, rritja ekonomike) nuk u përmbushën.

Sa i përket zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014, PDK dhe kryeministri Thaci do të mbahen në mend për mënyrën e të bërit fushatë dhe arritjes së koalicionit me një parti që proklamoi bashkimin kombëtar që është Lëvizja për Bashkim (LB), dhe dy partive tjera me parime religjioze, Partinë e Drejtësisë (PD) dhe Partinë Shqiptare Demokristiane (PSHDK). E vecanta e këtyre zgjedhjeve është se për herë të parë në zgjedhje parlamentare PDK-ja është deklaruar si parti e djathtë, ndërsa në të kaluarën ishte konsideruar si parti me vlera social-demokrate dhe e afërt me parti të profilit të njëjtë në Europë<sup>50</sup>.

## - LDK

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është partia e parë shqiptare dhe si e tillë e fillon ciklin e pluralizmit politikë me ç'rast formohen edhe parti të tjera. LDK themelohet me 23 Dhjetor 1989 nga një grup i madh dhe divers intelektualësh. Lideri i parë i kësaj partie ishte Ibrahim Rugova, njëherit edhe lideri shpirtëror dhe identiteti i kësaj partie edhe sot e kësaj dite. Presidenti Rugova dhe LDK gëzonte mbështetje të padiskutueshme nga popullata shqiptare dhe për këtë ai u

zgjedh President i Republikës së Kosovës në vitin 1992 dhe në vitin 1998.<sup>51</sup>

LDK është partia e cila ka marrë pjesë në të gjitha proceset e vështira që e kanë percjellë Kosovën. Përkundër diversitetit ideologjik që kishin individë brenda partisë, LDK e udhëhequr nga presidenti Rugova u promovua si parti e qendrës së djathtë me qëllime të integritetit Euro-Atlantike. Pas përfundimit të luftës së vitit 1999, në zgjedhjet e para lokale të vitit 2000 LDK fitoi 58% të votave në nivel kombëtar.<sup>52</sup> Një vit më vonë LDK u confirmua si parti e parë në zgjedhjet parlamentare ku fitoi 47 nga 120 vende në parlament. Edhe pse LDK kishte një shumicë të konsoliduar, me ndërhyrjen edhe të komunitetit ndërkombëtar u formua qeveria gjithëpërfshirëse së bashku me LDK, PDK dhe AAK dhe presidenti i vendit u zgjedh Ibrahim Rugova.<sup>53</sup>

Në zgjedhjet e vitit 2004 LDK fitoi prapë me 45.4% të votave, dhe vendosi që të bëjë koalicion me AAK-në, parti e cila udhëhiqej nga një ish komandant i luftës z. Ramush Haradinaj. Ky i fundit u zgjedh kryeminister. Në anën tjetër LDK mori postin e presidentit ku u confirmua Ibrahim Rugova dhe kryetar i parlamentit Nexhat Daci.

Momentum negativ i LDK-së erdhi pas vdekjes së liderit Rugova në vitin 2006 dhe punimet e kuvendit për zgjedhjen e strukturave të reja. Pas një fushatë të brendshme shumë të tensionuar dhe një kuvendi zgjedhor i percjellur me probleme dhe konflikte, partia përfundimisht u nda në dysh, ku Nexhat Daci me një grup tjetër të të pakënaqurish formuan një parti të re, Lidhjen Demokratike të Dardanisë (LDD).

Pas problemeve të brendshme partiake pas ndarjes në dysh të partisë, pas humbjes së liderit karizmatik dhe të pakontestueshëm, Ibrahim Rugovës, LDK në zgjedhjet e 2007-ës merr përgjysmë më pak vota, gjithsej 22.60% dhe bëhet partia e dytë në vend. LDK bën marrëveshje me rivalin kryesor PDK dhe merr postin e presidentit të cilin post e ushtron Fatmir Sejdiu.

<sup>49</sup> Zyrtare: Qeveria rrite pagat 25 perqind, Artikulli mund të gjindet ne: <http://botasot.info/kosova/280328/zyrtare-qeveria-rrite-pagat-per-25-per-qind/>, shikuar se fundmi me 26.05.2014

<sup>50</sup> Hofmeiser, Wilhelm dhe Grabow, Karsten, Partitë politike, Funkcioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike. Kapitulli 8, Partitë Politike në Kosovë, Xhemaj, Bashmir, faqe 106, Prishtinë, Prill 2013. Editor dhe botues: Fondacioni Konrad Adenauer. Ky libër mund të gjendet në : [http://www.kas.de/wf/doc/kas\\_34067-1522-2-30.pdf?130417185744](http://www.kas.de/wf/doc/kas_34067-1522-2-30.pdf?130417185744) .

<sup>51</sup> International Crisis Group, WHO'S WHO, Pristina - Washington, 31.08.1999, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/076-whos-who-in-kosovo.aspx>

<sup>52</sup> International Crisis Group, Kosovo: Landmark Elections, 21.11.2001 gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/120-kosovo-landmark-election.aspx>

<sup>53</sup> Kosovo Profile, Artikulli mund të gjendet në: <http://www.bbc.com/news/world-europe-18331273> shikuar së fundmi më 26.05.2014

Gjatë kësaj kohe pakënaqesitë e koalicionit me PDK-në ishin të mëdha ndërkohë që në skenë po ngrihej një figurë tjetër në LDK, një figurë më karizmatike dhe që kundërshtonte haptazi qeverisjen e LDK-së me PDK-në, kryetari i komunës së Prishtinës prof. Isa Mustafa. Në vitin 2010 pas procedimit të lëndës në Gjykatën Kushtetuese me pyetjen nëse Fatmir Sejdiu kishte shkelur kushtetutën duke mbajtur dy pozita, atë të Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të LDK-së, gjykata vendos që është në shpërputhje me Kushtetutën e Kosovës. Me këtë rast presidenti Sejdiu dorëhiqet personalisht por me vete e tërheq edhe partinë nga koalicioni<sup>54</sup>. Dhe po në vitin 2010 në kongresin e radhës së LDK-së, ai që kishte kundërshtuar më së shumti PDK-në, Isa Mustafa u zgjodh në krye te partisë.<sup>55</sup>

Në zgjedhjet komunale te vitit 2013 fitoi shumicën e komunave më të mëdha në Kosovë por duke humbur komunën më të madhe në vend, Prishtinën<sup>56</sup>. Në këto zgjedhje LDK futet me disa emra të rinjë dhe të respektuar nga shoqëria civile dhe bota akademike dhe synon t'ia pamundësojë një mandat të tretë qeverisës Hashim Thaqit.

## - AAK

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), është një bashkim i disa organizatave politike dhe individëve me ideologji ndoshta edhe të kundërta. Në formimin e saj në vitin 2001, AAK-ës iu bashkuan Lëvizja Kombëtare për Clirimin e Kosovës (LKCK), UNIKOMB, Partia Parlamentare e Kosovës (PPK) dhe Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK).<sup>57</sup>

Përkundër diversitetit politik dhe ideologjik të individëve, AAK-ja është rreshtuar si parti e qendrës së djathtë. Lideri i saj është Ramush Haradinaj një gjeneral i shquar në luftën e UCK-ës. Përkundër kësaj kjo parti deri më tash nuk ka arritur të rivalizojë dy partitë më të mëdha LDK dhe PDK. Konkretisht në

zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 AAK fiton vetëm 7.83% të votave, ndërsa në zgjedhjet lokale të vitit 2002 arrin ta fitoj vetëm komunën e Decanit, prej nga vjen edhe Ramush Haradinaj. Sidoqoftë AAK-ja përfshihet në koalicionin e gjerë së bashku me partitë e tjera duke marrë disa ministri nën udhëheqje.

Përvoja qeveritare e AAK-së vazhdohet më tutje pas formimit të koalicionit me LDK-ën në vitin 2004. Në këto zgjedhje AAK fitoi vetëm 9.60% te votave por i mjaftoi të merrte postin e kryeministrit. Sidoqoftë, mandati qeverisës u përshkrua me shumë ngjarje duke u bërë qeveria që për një mandat udhëhiqet nga tre kryeministra të ndryshëm. Fillimisht në vitin 2005 kryeministri Haradinaj u dorëzua në gjykatën e Hagës, ku ishin ngritur akuza për krime gjatë luftës në Kosovë.<sup>58</sup> Në mars të vitit 2005 vendin e tij e zuri Bajram Kosumi ku vetëm pas një viti dha dorëheqje. Kosumi u zëvendësua nga ish gjenerali i UCK-ës dhe lejtanti i TMK-ës, Agim Ceku i cili qëndroi deri në zgjedhjet e vitit 2007.<sup>59</sup>

Mos prezenca e liderit Haradinaj në zgjedhjet parlamentare-lokale të vitit 2007, zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, e dëmtoi rëndë si parti dhe kjo sigurisht ndikoi në rezultate. Megjithatë AAK arriti që në rajonin e Dukagjinit të konfirmohej si parti e parë, duke fituar Gjakovën, Pejën dhe përtej këtij rajoni edhe Suharekën.

Zgjedhjet lokale te vitit 2013 ishin negative për AAK-në pasi që nga gjashtë komuna sa kishte arriti ti fitonte vetëm tri, Decanin, Junikun dhe Obilicin. Humbje të mëdha vlerësohen të jenë, humbja e komunave të rajonit të Dukagjinit, Gjakova dhe Peja pasi qe ky rajon njihej edhe si bastion i AAK-ës. Sidoqoftë në këto zgjedhje AAK ka arritur që të ngritë votën nacionale, që është një element i rëndësishëm për këtë subjekt për ti hyrë garës për zgjedhjet e qershorit 2014. Një element tjetër i rëndësishëm është pjesëmarrja e liderit karizmatik Haradinaj pas dhjetë vitesh në një fushatë për zgjedhjet parlamentare.

<sup>54</sup> Sejdiu jep doreheqje, Artikulli mund të gjendet: <http://www.evropaelire.org/content/article/2169631.html>, shikuar së fundmi më 27.05.2014

<sup>55</sup> Isa Mustafa zgjidhet kryetar i LDK-ës, Artikullin mund ta gjeni në: <http://botasot.info/speciale/86719/qYzLnhl/>, shikuar së fundmi me 27.05. 2014

<sup>56</sup> LDK humb Prishtinën fiton Kosovën, Artikullin mund ta gjeni në <http://www.zeri.info/artikulli/21955/ldk-humb-prishtinen-fiton-kosoven>, shikuar se fundi më 27.05.2014

<sup>57</sup> International Crisis Group, Kosovo: Landmark Elections, gjendet në 21.11.2001 <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/120-kosovo-landmark-election.aspx>

<sup>58</sup> International Crisis Group, Kosovo: No Good Alternatives to the Ahtisaari Plan, 14.052007, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/182-kosovo-no-good-alternatives-to-the-ahtisaari-plan.aspx>

<sup>59</sup> Kosovo Profile, Artikulli mund te gjendet në: <http://www.bbc.com/news/world-europe-18331273>, 'shikuar se fundi me 26.05.2014

## - VETËVENDOSJE

Lëvizja Vetëvendosje është themeluar më 10 Qershor 2005, nga një grup i intelektualëve të rinj në moshë por me bagazh nga e kaluara. Të udhëhequr nga Albin Kurti, që njihet për organizimin e protestave të vitit 1997, pjesëtar i zyrës politike të UCK-ës dhe i burgosur gjatë luftës, fillimisht lëvizjen Vetëvendosje e profilizoi si një lëvizje që si kauz të saj kishte bashkimin kombëtar. Vetëvendosja veprimet e tyre i zhvillonte përmes aksioneve politike, protestave dhe demonstratave. Demonstratat dhe protestat e organizuara nga Vetëvendosje, shpesh dilnin edhe nga kontrolli, dhe me tragjikja ishte ajo e 10 Shkurtit 2007, kur dy protestues u vranë nga policia e UNMIK-ut.<sup>60</sup>

Lëvizja Vetëvendosje kishte kundërshtime si për komunitetin ndërkombëtar ashtu edhe për partitë politike shqiptare të cilët sipas tyre po e shisnin vendin dhe po krijonin një identitet të ri dhe artificial. Vetëvendosje paraqiste nevojën imediate për bashkim me Shqipërinë, që do të ishte edhe mënyra më e mirë për tu distancuar nga Serbia, dhe për të ruajtur integritetin territorial. Vetëvendosje nuk morri pjesë në zgjedhje deri në vitin 2010. Përkundrazi, gjatë kësaj kohe ata kundërshtuan zgjedhjet, institucionet e Kosovës, Pakon e Ahtisarit, decentralizimin, privatizimin, dhe kërkonte largimin e UNMIK-ut.<sup>61</sup>

Gjithsesi pika kthyesë e Vetëvendosjes ishte pjesmarrja në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 ku mori 12.69% të votave. Duhet të ceket se në këto zgjedhje, Vetëvendosje hyri në koalicion parazgjedhor me Lëvizjen për Bashkim (LB), një parti e përafërt për nga ideologjia por me të cilët u ndanë menjëherë pas zgjedhjeve pasi që kishin probleme me ndarjen e të hyrave nga buxheti i Kosovës për partitë politike.<sup>62</sup> Sidoqoftë, grupi parlamentar gjatë gjithë kohës ishte aktiv dhe në të gjitha rastet qendroi konsistent në veprimet e tyre, duke mos dal kundër parimeve dhe programit të tyre që për nga ideologjia përkrahte fuqishëm politikën e majta.

<sup>60</sup> International Crisis Group, *Kosovo: No Good Alternatives to the Ahtisaari Plan*, 14.05.2007, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/182-kosovo-no-good-alternatives-to-the-ahtisaari-plan.aspx>

<sup>61</sup> International Crisis Group Europe Report *Kosovo: The Challenge of Transition* 17.02.2006, gjendet në <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/170-kosovo-the-challenge-of-transition.aspx>

<sup>62</sup> Percahen Aleatet, *Artikulli mund të gjendet në:* <http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/percahen-aleatet>, shikuar se fundmi me 26.05.2014

Megjithatë diskursi i lëvizjes Vetëvendosje ndryshoi me aderimet e disa individëve të cilët ishin të koncentruar më shumë në arritjen e rezultateve të prekshme. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 kur po mendohej se Lëvizja Vetëvendosje po dështonte duke mos arritur të fitojë asnjë komunë, Shpend Ahmeti mori shumicën e votave dhe u shpall kryetar komune.<sup>63</sup>

Pa diskutim kjo fitore e kryeqendrës ishte edhe shpëtimi i lëvizjes Vetëvendosje të cilët duke e parë që hapja e lëvizjes solli freski, vendosën që të sjellin edhe prurje të reja për të qenë sa me konkures në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014.

## - AKR

Aleanca Kosova e Re (AKR), është themeluar me 3 Maj 2006 nga Behgjet Pacolli, një biznesmen shumë i sukseshëm ndërkombëtar.<sup>64</sup>

Duke e ditur biografinë e z.Pacolli, qytetarët e vendit e vlerësuan me një pozitivitet, sa që në zgjedhjet e vitit 2007 u bë partia e tretë me 12.3% të votave. Përkundër kësaj AKR qëndroi në opozitë. Pas një lulëzimi të kësaj partie, filluan edhe çarjet e para me braktisjen e deputetëve ku disa zgjodhën të jenë të parvarur dhe disa iu bashkangjiten partive tjera.

Goditja e rradhës ishin zgjedhjet komunale, ku edhe pas koalicionit me LDD, nuk arriti të fitojë asnjë komunë të vetme. Duke e parë trendin në rënje, AKR për zgjedhjet parlamentare të vitit 2010 bëri koalicion me një sërë partish të vogla dhe arritën të fitonin vetëm 7.29%. Përkundër problemeve të brendshme si koalicion, AKR së bashku me partitë e tjera arriti të bëjë koalicion me PDK-në dhe presidenti i AKR-ës Behgjet Pacolli u zgjodh President i Kosovës pas shumë pakënaqësive dhe rivotimesh.

Qetësia për AKR-në dhe veqanërisht z.Pacolli nuk zgjati pasi vetëm pas 35 ditësh Gjykata Kushtetuese vlerësoi se mënyra e zgjedhjes së tij ishte anti kushtetuese, kështu Pacolli dha dorëheqje. Sifoqoftë AKR qëndroi deri në fund në koalicion, ku udhëheqti me disa ministri.

<sup>63</sup> Presin ndryshime dhe permbushje zotimesh, *Artikulli mund të gjendet në:*

<http://www.evropaelire.org/content/article/25187209.html>, shikuar me 27.05.2014

<sup>64</sup> <http://akr-ks.com/akr/historiku/>

Si pikë kthese për AKR-në mund të quhen fitorja në Gjakovë dhe Mitrovicë në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Kjo si duket e ka relaksuar z.Pacolli i cili në listën për kandidatë të zgjedhjeve parlamentare ka futur disa persona të rinj dhe politikanë me pervojë sic janë Bajram Kosumi apo Naim Maloku.

## **- LISTA SERBE – GRADANSKA INICIJATIVA SRPSKA (G.I.SRPSKA)**

Formimi i Listës Serbe vjen si pasojë e dialogut politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që si produkt kishin marrëveshjen e Prillit të vitit 2013. Faktikisht me pjesëmarrjen e Listës Serbe në zgjedhje, për herë të parë i gjithë komuniteti serb pranon që të bëhet pjesë e këtij procesi.

Përkundër asaj që është arritur një hap i rëndësishëm i integritetit të serbëve të veriut me pjesëmarrjen në zgjedhje, këta të fundit po e kanë problem ta njohin autoritetin e Prishtinës. Në fakt serbët e veriut janë të zhgënjyer edhe nga Beogradi pasi që interesat e tyre nuk janë marrë për bazë fare. Për më tepër serbët e veriut janë shumë të tensionuar pas paralajmërimit të bashkimit të listës serbe dhe SLS-ës, për të cilat thonë se janë njerëz të Thacit.<sup>65</sup> Megjithatë lista serbe në zgjedhjet komunale arriti suksese ku fitoi nëntë komuna.<sup>66</sup>

## **BIOGRAFI TË SHKURTA TË LIDERËVE KRYESOR POLITIKË**

### **- Hashim Thaci**

Ka lindur me 24 Prill 1968 në Buroj të Skenderajit. Në vitin 1993 përfundon studimet në degën e Historisë pranë Universitetit të Prishtinës. Nga viti 1996 deri në vitin 1998 ka ndjekur studimet në degën e historis dhe shkencave politike në Cyrih të Zvicrës. Nga viti 1989 ishte pjesë e LPK-ës dhe njëherit ishte i përndjekur politik. Thaci është njëri nga themeluesit e UCK-ës dhe drejtues politik i saj. Prej kësaj kohe e deri tani Thaci ishte pjesë e të gjitha proceseve politike që kanë të bëjnë me Kosovën. Fillimisht ishte udhëheqësi delegacionit shqiptar në Rambuje, pastaj pjesëmarrës

<sup>65</sup> Nga debati i organizuar nga Center for Social Engagement me përkrahjen e Fondacionit KAS që kishte për qëllim ngritjen e pjesëmarrjes të komunitetit serb në zgjedhje. Mitrovicë, 15.05.2014.

<sup>66</sup> Komisioni Zgjedhor i Kosovës., Zgjedhjet për Kuvendin Komunal 2013. <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-komunale-2013>

në bisedimet e Vjenës dhe tani në bisedime me Beogradin. Në vitin 1999 Hashim Thaci ka themeluar PDK-ën dhe që nga ajo kohë është kryetari i padiskutueshëm i kësaj partie<sup>67</sup>. Që nga viti 2007 Hashim Thaci është kryeministër i Republikës së Kosovës pasi që partia e tij ka dalë fituese në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 dhe 2010. Hashim Thaci i prinë listës së PDK-ës dhe është i nominuar për kryeministër nga kjo parti.

### **- Isa Mustafa**

Ka lindur me 15 Maj 1951 në Prapashticë komuna e Prishtinës. Profesor Mustafa ka doktoruar në ekonomi, dhe është ligjërues që nga viti 1974. Prof. Mustafa, si ligjërues kohën më të madhe e ka kaluar në Universitetin e Prishtinës por edhe në disa universitete tjera private. Lidhja e tij me komunën e Prishtinës fillon qysh në vitin 1984 kur ushtronte detyrën e kryetarit të qeverisë komunale deri në vitin 1988. Mustafa ka qenë pjesë e shumë bordeve të institucioneve bankare dhe universiteteve. Karriera e tij politike vazhdon si ministër i ekonomis, në qeverinë e Bujar Bukoshit nga viti 1991-1999.<sup>68</sup> Rikyqja e tij aktive në politike fillon në zgjedhjet e vitit 2007 kur kandidon dhe fiton zgjedhjet për të parin e komunës së Prishtinës. Isa Mustafa në vitin 2010 në Kuvendin e VII zgjedhor zgjedhet kryetar i LDK-ës. Mustafa në zgjedhjet lokale 2013, humbi zgjedhjet për kryetar të Prishtinës, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 është kandidat për kryeministër nga rradhët e LDK-ës.

### **- Ramush Haradinaj**

Ka lindur me 3 Korrik 1968 në Glllogjan të Decanit. Një pjesë të jetës e kaloi në mërgim në Zvicër. Në kohën e luftës ai u angazhua si gjeneral ushtarak për rajonin e Dukagjinit. Haradinaj gjatë luftës dha dëshmorë dy vëllezërit e tij Shkëlzenin dhe Luanin. Pas luftës, ai vazhdoi angazhimin ushtarak por tani si gjeneral në TMK, deri sa në vitin 2001 themeloi AAK-ën kështu duke ju bashkuar politikës. Në vitin 2004 Haradinaj si kryetar i AAK-ës arriti koalicion me presidentin Rugova, dhe kështu morri postin e kryeministrit. Pas vetem 100 ditëve si kryeministër, gjykata shpalli akt akuzë për krime gjatë luftës në Kosovë. Kështu Haradinaj dha dorëheqje nga posti i kryeministrit dhe iu dorëzua gjy-

<sup>67</sup> Biografia e Hashim Thacit: <http://www.kryeministri-ks.net/hashim-thaci-prime-minister-biography>

<sup>68</sup> Biografia e I sa Mustafës: <http://ldk-ks.eu/Al/organizimi/kryetari/>

katës deri në vitin 2008 kur u shpall i pafajshëm. Megjithatë, gjykata e Hagës në vitin 2010 hapi përsëri rastin e tij dhe Haradinaj prap u përball me gjykatën deri në vitin 2012 kur përfundimisht u shpall i pafajshëm<sup>69</sup>. Haradinaj ne zgjedhjet e vitit 2014 i prinë listës së kandidatëve të AAK-ës dhe është i nominuar për kryeministër nga ky subjekt.

#### - Albin Kurti

Ka lindur me 24 Mars 1975 në Prishtinë. Përfundoi studimet në fakultetin e Elektroteknikës më 1993. Angazhimi i tij më i madh ishte gjatë demonstratave të vitit 1997 ku së bashku me Unionin Studentor të UP-ës dhanë mesazh për gjendjen e rëndë të Kosovës. Gjatë luftës ai ishte pjesë e zyrës politike të UCK-ës së bashku me Adem Demacin. Ne vitin 1999 Albini u arrestua dhe qëndroi në burgjet e Serbisë deri në vitin 2001. Angazhimi i pasluftes fillon me Rrjetin e Aksionit për Kosovën (KAN) për të vazhduar në vitin 2005 me themelimin e Vetëvendosjes.<sup>70</sup> Albin Kurti ne vitin 2010 është zgjedhur deputet i Parlamentit të Kosovës dhe Kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme. Kurti vazhdon të jetë lider i padiskutueshëm i lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidat për kryeministër i këtij subjekti.

#### - Behgjet Pacolli

Ka lindur me 30 Gusht 1951 në Marec komuna e Prishtinës. Edukimin e ulët e ka përfunduar në Kosovë ndërsa studimet për tregti dhe marketing i ka përfunduar jashtë vendit në Gjermani dhe Zvicër. Pacolli është nje biznesmen i sukseshëm dhe pronar i shum kompanive. Pacolli njihet edhe si humanist i cili përmes fodacioneve ka ndihmuar në rindertim, edukim dhe sfera tjera të jetës. Pacolli në vitin 2005 bëhet pjesë e politikës së Kosovës, duke formuar AKR-në<sup>71</sup>. Në vitin 2010 u zgjodh President i Republikës së Kosovës ku qëndroi vetëm 35 ditë, pasi që Gjykata Kushtetuese vlerësoi se procedura e zgjedhjes së tij ishte në kundërshtim me kushtetutën. Pacolli gjatë qeverisjes 2010-2014 ishte zëvendës kryeministër i Kosovës me fokus më të madh në procesin e politikës së jashtme dhe lobimit për njohje.

<sup>69</sup> Profili i Ramush Haradinajt:

<http://www.bbc.com/news/world-europe-14542505>

<sup>70</sup> Albin Kurti: <http://www.melevizjen.com/kandidatet/1-albin-kurti/>

<sup>71</sup> Biografia e Behgjet Pacolli:

<http://www.behgjetpacolli.com/biografia/>

## Burime të shfrytëzuara

Hofmeister, Wilhelm dhe Grabow, Karsten, *Partitë politike, Funkzioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike. Kapitulli 8, Partitë Politike në Kosovë, Xhemaj, Bashmir.*

*International Crisis Group Europe Report Kosovo: The Challenge of Transition*

<http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/170-kosovo-the-challenge-of-transition.aspx>

*International Crisis Group, Kosovo: Landmark Elections, gjendet në*

<http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/120-kosovo-landmark-election.aspx>

*International Crisis Group, Kosovo: No Good Alternatives to the Ahtisaari Plan, gjendet në*

<http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/182-kosovo-no-good-alternatives-to-the-ahntisaari-plan.aspx>

*Crisis Group, "What Happened to the KLA", gjendet në*

<http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/088-what-happened-to-the-kla.aspx>

*International Crisis Group, Kosovo RoadMap(II): Internal Benchmarks, , gjendet në*

<http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/op-eds/125-a-kosovo-roadmap-II-internal-benchmarks.aspx>

*International Crisis Group, Kosovo After Haradinaj, gjendet në*

<http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo/163-kosovo-after-haradinaj.aspx>

Komisioni Zgjedhor i Kosoves., Zgjedhjet per Kuvendin Komunal 2013

*Percahen Aleatet, Artikulli mund te gjendet në:*

<http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/percahen-aleatet/>

*Presin ndryshime dhe permbushje zotimesh, Artikullin mund te gjindet në:*

<http://www.evropaelire.org/content/article/25187209.html>

<http://akr-ks.com/akr/historiku/>

*Kosovo Profile, Artikulli mund te gjendet në:*

<http://www.bbc.com/news/world-europe-18331273>

*Sejdiu jep doreheqje, Artikulli mund të gjendet:*

<http://www.evropaelire.org/content/article/2169631.html>

*Isa Mustafa zgjidhet kryetar i LDK-ës, Artikullin mund ta gjeni në:*

<http://botasot.info/speciale/86719/qYzLnhl/>

*LDK humb Prishtinën fiton Kosovën, Artikullin mund ta gjeni në <http://www.zeri.info/artikulli/21955/ldk-humb-prishtinen-fiton-kosoven/>,<sup>1</sup> International*

Zyrtare: Qeveria rrite pagat 25 perqind, Artikulli mund të gjendet në:

<http://botasot.info/kosova/280328/zyrtare-qeveria-rrite-pagat-per-25-per-qind/>,

Miliona Euro për fushatë, Artikulli mund të gjendet në <http://www.zeri.info/artikulli/31353/miliona-euro-per-fushate>,

Ligji Nr. 03/L-073, Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,

Kosovo Profile, Artikulli mund të gjendet në:

<http://www.bbc.com/news/world-europe-18331273>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

Kosova në krizë pasi LDK largohet nga qeveria. Artikulli mund të gjendet në:

<http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2010/10/18/feature-01>

Kosovo's election. Calm now, a storm to come?.

Artikulli mund të gjendet në:

[http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2010/12/kosovos\\_election](http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2010/12/kosovos_election),

Forum 2015: Mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë. 2013. Punuar nga Instituti Demokratik i Kosovës.

Artikulli mund të gjendet në: <http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/09/Mbi-10-vjet-Parlamentarizem-ne-Kosove-ALB.pdf>

Sejdiu e ka shkelur seriozisht Kushtetutën. Artikulli mund të gjendet në:

<http://www.telegafi.com/lajme/sejdiu-e-ka-shkelur-seriozisht-kushtetuten-2-10483.html>,

Kuvendi i Kosovës miratoi themelimin e Gjykatës speciale. Artikulli mund të gjendet në:

<http://www.telegafi.com/lajme/kuvendi-i-kosoves-miratoi-themelimin-e-gjykates-speciale-2-43822.html>,

Zgjedhjet e përgjithshme: <http://www.kqz-ks.org/sq/zgjedhjet-e-pergjithshme>,

Përmbledhje e zgjedhjeve. Artikulli mund të gjendet në:

[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/info/Elections/setimes/resource\\_centre/elections/kosovo\\_assembly\\_2001?country=Kosovo](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/info/Elections/setimes/resource_centre/elections/kosovo_assembly_2001?country=Kosovo)

<sup>1</sup> Forum 2015: Mbi 10 vjet parlamentarizëm në Kosovë. 2013. Punuar nga Instituti Demokratik i Kosovës.

Artikulli mund të gjendet në: <http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/09/Mbi-10-vjet-Parlamentarizem-ne-Kosove-ALB.pdf>

Presidentët e Kosovës. Dr. Ibrahim Rugova, Presidenti historik i Kosovës. <http://www.president-ksqov.net/?page=1,109>,<sup>1</sup>

Bajram Rexhepi. Kryeministër i Kosovës. Artikulli mund të gjendet në:

<http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/info>

[Bios/setimes/resource\\_centre/bio-archive/rexhepi\\_bajram](http://Bios/setimes/resource_centre/bio-archive/rexhepi_bajram)

Zgjedhjet Mbahen më 8 Qershor. Artikulli mund të

gjendet në: <http://qazetajnk.com/?cid=1,1018,8174>

<http://www.telegafi.com/lajme/me-90-vota-per-shperndahet-kuvendi-i-kosoves-2-44465.html>

<http://www.qazetatema.net/web/2011/01/07/edhe-mitrovica-ne-rivotim/>

<http://www.abcnews.al/lajme/rajoni/7/2791>

<http://www.dw.de/presidenti-sejdiu-iej-dor%C3%ABheqjen/a-6049627>

[http://www.balkanweb.com/bw\\_lajme2.php?IDKategori=2686&IDNotizia=50742&res\\_start=40](http://www.balkanweb.com/bw_lajme2.php?IDKategori=2686&IDNotizia=50742&res_start=40)

<http://botasot.info/kosova/105503/behqjet-pacolli-president-i-kosoves/7>

<http://www.evropaelire.org/content/article/2324780.html>

<http://lajmetshqip.com/kosove-qjykata-kushtetuese-rrezon-presidentin-pacolli/>

<http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/atifete-jahjaga-kandidate-per-presidente-te-kosoves>

<http://www.vetevendosje.org/jo-negociata-vetevendosje/>

Nënshkruhet marrëveshja Kosovë – Serbi.

<http://koha.net/arkiva/?page=1,13,143112>.

Megjithë tensionimin Kuvendi ratifikoi marrëveshjen

Kosovë-Serbi. Artikulli mund të gjendet në:

<http://www.telegafi.com/lajme/megjithe-tensionimin-kuvendi-ratifikoi-marreveshjen-kosove-serbi-video-2-33514.html>.

Biografia e Hashim Thaqit. [www.kryeministri.net](http://www.kryeministri.net)

Biografia e Isa Mustafës. [www.ldk-ks.eu](http://www.ldk-ks.eu)

Profili i Ramush Haradinajt. [www.bbc.co.uk](http://www.bbc.co.uk)

Biografia e Albin Kurtit: [www.melevizjen.com](http://www.melevizjen.com)

Biografia e Behgjet Pacollit: [www.behqjetpacolli.com](http://www.behqjetpacolli.com)

## Informata të shkurta për autorët

**Granit Tërnav** u lind më 03.07.1988. Ai ka përfunduar Shkencat Politike në Universitetin e Prishtinës më 2010 dhe ka përfunduar të gjitha provimet në programin master për Shoqëri Civile dhe Zhvillim Lokal. Ai ka qenë pjesë e organizatave të ndryshme të fushës së organizatave rinore dhe të qeverisjes lokale siq janë Asociacioni i Komunave të Kosovës, të Rinjtë për të ardhmen, Qendrës Rinore në Fushë-Kosovë dhe Iniciativës për Zhvillim Lokal. Ai ka ndjekur seminare në Kosovë dhe jashtë saj nga fusha e Integritimeve Europiane, Negociatave, Menaxhimit të Konflikteteve dhe ndërtimit të shoqërisë demokratike dhe komunikimit etnik dhe fetar.. Me sukses është graduar në Shkollën për Integritime Europiane. Ka përfunduar edhe Shkollën Politike të Prishtinës dhe pjesëmarrës i Forunit Botëror në Strasburg me pjesëmarrës nga dhjetëra vende të botës. Ka punuar disa analiza të shkurta politike dhe ka punuar vitin e kaluar në një format të tillë të manualit për zgjedhjet e kaluara lokale. Ka qenë bursist i Fondacionit Konrad Adenauer gjatë studimeve të tij master ndërsa nga viti 2013 është i punësuar si Bashkëpunëtor Shkencor në të njëjtin fondacion.

Email: [granit.ternava@gmail.com](mailto:granit.ternava@gmail.com)

**Milot Rexhepi** u lind më 19.12.1987 ne Prishtinë. Ai ka përfunduar studimet në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Krahas studimeve, u angazhua në Departamentin e Shkencave Politike dhe u zgjodh kryetar i Unionit të Studentëve. Që nga viti 2009 është i angazhuar në organizatën jo qeveritare Young European Federalist (JEF) në pozitën e Sekretarit Gjeneral. Në vitin 2010 u angazhua si hulumtues në Iniciativën Kosovare për Stabilitet (IKS) ku punoi deri në vitin 2012. Miloti gjatë gjithë kësaj periudhe është angazhuar si hulumtues në projekte socio-ekonomike dhe integritime evropiane. Ka marrë pjesë në shumë konferenca dhe trajnime si brenda edhe jashtë vendit dhe është bashkë-autor i disa publikimeve. Aktualisht është pjesë e disa projekteve që kanë të bëjnë me sistemin zgjedhor.

Email: [milot\\_rexhepi@hotmail.com](mailto:milot_rexhepi@hotmail.com)

**Pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorëve dhe ato nuk paraqesin domosdoshmërisht qendrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.**

### Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung  
Zyra në Kosovë  
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6  
KO-10000 Pristina  
Telefon +381 (0) 38 229 874  
[Prishtina@kas.de](mailto:Prishtina@kas.de)  
[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)